



**Republika e Kosovës / Republika Kosovo**  
**Kuvendi Komunal Dragash / Skupština Opštine Dragaš**



Duke u bazuar në nenin 40.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/15, qershor 2008), neni 32, paragrafi 2 i Statutit të Komunës së Dragashit. 01 nr.06-103/1 datë 11.09.2008, Kuvendi i Komunës së Dragashit , në seancën e mbajtur me 29.02.2024 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak miraton këtë:

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**DRAGASHIT PËR VITIN 2024**

- I. MIRATOHET Plani i punës së Kuvendit të komunës së Dragashit për vitin 2024.
- II. Plani i punës së Kuvendit të komunës së Dragashit për vitin 2024 është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Ndryshimet dhe Plotësimet e Planit të punës së Kuvendit mund të bëhen edhe pas miratimit të tij, pëderisa çështjet që janë në kompetencë të Kryetarit të Komunës do të shqyrtohen edhe pa qenë të përfshira në planin e punës.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i K.K. Dragash.
- V. Vendimi hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit pranë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në webfaqen e Komunës.

**KUVENDI KOMUNAL DRAGASH**


01 Nr. 060/01-410/24-5

Dt. 29.02.2024



**Kryesuesja e Kuvendit**  
**Arijeta Skeraj**

*A. Skeraj*



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/ Republic of Kosovo



## **Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/ Dragash Municipality**

Në bazë të nenit 4, pika d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 32 të Statutit të Komunës, pas shqyrtimit paraprak, në seancën e Kuvendit Komunal të Dragashit, më dt. 29.02.2024 miratohet ky:

### **Plani i Punës së Kuvendit Komunal, për vitin 2024**

Kuvendi i Komunës së Dragashit, si organ më i lartë legjislativ i Komunës, ka për objektiv ndërtimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në mes Kuvendit dhe Ekzekutivit të Komunës, qytetarëve, organeve të pushtetit qendror dhe OJQ-ve, që të mundësoj ndërtimin dhe zhvillimin e demokracisë, transparencës, respektimin dhe zbatimin e të gjitha ligjeve, si dhe miratimin dhe harmonizimin e të gjitha akteve normative Komunale me ligjet dhe U/A në fuqi që rregullojnë çështjet me interes të përgjithshëm për Komunën dhe qytetarët e sajë.

Gjatë vitit kalendarak - 2024, konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës Dragash, Kuvendi Komunal i Dragashit parashihet të mbanë, së paku, 10 seanca të rregullta dhe të jashtëzakonshme (sipas nevojës). Në seanca, konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit, do të shqyrtohen dhe miratohen rregullore, vendime, pëlqime, rekomandime dhe çështje tjera me interes të cilat janë nën kompetencën dhe fushëveprimin e tij si organ më i lart legjislativ i Komunës.

Sic parashihet, seancat do të caktohen nga Kryesuesi i Kuvendit, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, si dhe me kërkesën e 1/3 së delegatëve.

Me rendin e paraparë të dritës së Kuvendit, seancat do të jenë transparente (në vende publike, media dhe web-faqën e Komunës), si dhe të hapura për publikun. Si zakonisht, rendi i dritës dhe materiali shpërndahet 7 (shtatë) ditë pune para mbajtjes së tyre, kurse për ato të jashtëzakonshme 3 (tri) ditë pune para mbajtjes së tyre.

Seancave të Kuvendit, si praktikë e arsyeshme deri tani, do t'u paraprijnë mbledhjet paraprake të 2 komiteve obligative të Kuvendit (Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitetë), ku shqyrtohen parapërgatitjet për Kuvend, si dhe shqyrtohen e miratohen edhe çështje tjera nga fushëveprimi dhe kompetencat e komiteve obligative të Kuvendit.

Deri në miratimin e tij nga Kuvendi, ky Plan është i hapur për plotësime e ndryshime nga ana e delegatëve, subjekteve të përfaqësuara në Kuvend, organizatave vendore e ndërkombëtare dhe grupeve të qytetarëve, konform L.VL-së dhe Statutit të Komunës.

**Plani dhe dinamika e çështjeve, për shqyrtim e miratim në Kuvend – 2024**

Nr.	Tema	Subjekti realizues	Afati
1.	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit, për vitin 2024	Kuvendi	3 mujori i I-rë
2.	Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Ekzekutivit 2023 & Planeve të Punës, për vitin 2024	Kuvendi & Ekzekutivi	3 mujori i I-rë
3.	Raporti Vjetor Financiar 2023	Kuvendi & Ekzekutivi	3 mujori i I-rë
4.	Raporti 3- mujor financiar, për vitin 2023	Kuvendi & Ekzekutivi	3 mujori i II-të
5.	Takimi i I-rë Publik me qytetarë	Kryetari & ekzekutivi	3 mujori i II-të
6.	Shqyrtimi i Raportit të KKSBS-së 2023 & Planit të Veprimit 2024, rreth gjendjes së sigurisë	Kuvendi & S.policor – Dragash	3 mujori i I/II-të
7.	Rishikimi i buxhetit – 2024	Kuvendi & Ekzekutivi	3 mujori i II-të
8.	Raporti 6 mujor financiar, për vitin 2024	Kuvendi & Ekzekutivi	3 mujori i III-të
9.	Rregullore e vendime komunale...	Kuvendi & Ekzekutivi	(sipas nevojës)
10.	Dëgjime publike për Buxhejin e Komunës, për vitin 2025	Kuvendi & Ekzekutivi	3 mujori i III-të

11.	Miratimi i Buxheit për vitin 2025	Kuvendi & Ekzekutivi	3 majori i III-të
12.	Miratimi i Rregullores për tatimin në pronë, për vitin 2024	Kuvendi & Ekzekutivi	3 majori i III-të
13.	Raporti 9- mujor financiar, për vitin 2024	Kuvendi & ekzekutivi	3 majori i IV-të
14.	Shqyrtimi i gjendjes së arsimit, shëndetësisë, sigurisë etj. (sipas nevojës)	Kuvendi & organet kompetente të linjave	Në vazhdimësi
15.	Takimi i II-të publik me qytetarë	Kryetari & ekzekutivi	3 majori i IV-të
16.	Rezyme e Punës së Kuvendit – 2024	Kryesuesi dhe Shërbimi i Kuvendit	3 majori i IV-të
17.	Pyetje e përgjigje të delegatëve	Kuvendi & ekzekutivi	Në vazhdimësi
18.	Dëgjime tjera publike	Kuvendi & ekzekutivi	Sipas nevojës
19.	Shqyrtimi i kërkesave & komitetet	Kuvendi	Në vazhdimësi
20.	Tema tjera të propozuara nga delegatët & ekzekutivi etj.	Kuvendi	Në vazhdimësi

Përveç akteve të parapara, për shqyrtim, Kuvendi i Komunës mund të shqyrtoj edhe akte të tjera mbi:

- Organizimin e brendshëm;
- Çështjet financiare;
- Çështjet pronësore;
- Çështjet mjedisore;
- Çështjet e kulturës;
- Çështjet e urbanizmit;
- Çështjet e edukimit;
- Çështjet shëndetësore;
- Çështjet tjera, të arsyeshme
- Kuvendi, gjithashtu, mund të inicioj, shqyrtoj e miratoj edhe ndryshimin ose plotësimin e akteve ekzistuese.

Dinamika e këtij Plani, gjatë zbatimit, mund të ketë nevojë të plotësohet dhe ndryshohet, sipas nevojës dhe paraqites së kërkesave të reja - të arsyeshme, qoftë nga ana e qytetarëve, delegatëve të Kuvendit dhe Kryetarit të Komunës, organizatave vendore e ndërkombëtare, apo edhe të përgjegjësiëve të tjera që dalin nga miratimi ligjeve të reja dhe akteve tjera nënligjore të cilat janë të nevojshme, për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi Komunal.

01 Nr. 060/01-4101/24-5

Dt. 29.02.2024

D r a g a s h



Kryesuesja e Kuvendit  
Arijeta Skeraj

*Arijeta Skeraj*



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/Republic of Kosovo**  
**Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality**

---



## RAPORTI I KUVENDET PËR VETEN 2023



Dragash shkurt 2024

# R A P O R T

## E KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRAGASHIT PËR VITIN 2023

Të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës së Dragashit.

Para jush do të paraqesim raportin e punës, arritjeve dhe aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Dragashit për vitin 2023.

Përmes këtij raporti jemi munduar të paraqesim një pasqyrim të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet dhe punën e Kuvendit.

Qëllimi i këtij raporti është që të rrit transparencën dhe llogaridhënien e Kuvendit të Komunës së Dragashit.

Kuvendi i Komunës detyrat e veta i ka ushtruar në përputhje me:

- Ligjin për Vetëqeverisje Lokale ( Ligji Nr. 03/L-040),
- Statutin e Komunës së Dragashit 01 Nr. 06-103/1 të datës 11.09.2008,
- Rregulloren e Punës së Kuvendit 01 Nr.06-52/22 të dt. 21.07.2010,
- Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023 dhe
- Aktet tjera ligjore dhe nënligjore të Republikës së Kosovës të cilat prekin fushëveprimin e Kuvendit të Komunës.



## I. KUVENDI I KOMUNËS

Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2023 ka mbajtur gjithsejtë 13 mbledhje, prej të cilave 10 mbledhje kanë qenë të rregullta dhe 3 mbledhje të jashtëzakonshme, u trajtuan gjithsejtë 50 pika të rendit të ditës dhe u miratuan vendime, raporte, konkluzione, reagime etj., gjithashtu gjatë vitit 2023 kemi mbajtur 1 mbledhje solemne.

Gjatë vitit 2023 Kuvendi i Komunës ka miratuar 39 Vendime.

Vlen të theksohet se Kryetari i Komunës ka marr pjesë në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, ku në vazhdimësi i është përgjigjur pyetjeve dhe kërkesave të delegatëve të Kuvendit.

## II. MONITORIMI I KUVENDIT TË KOMUNËS DHE TRANSPARENCA

Gjatë kësaj periudhe Kuvendi i Komunës së Dragashit është monitoruar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), mediat lokale, OSBE, qytetarë të Komunës së Dragashit, etj.

## III. PUBLIKIMI I AKTEVE TË NË UEB FAQËN ZYRTARE TË KOMUNËS SË DRAGASHIT

- Si mjet kryesor për të ofruar qasjen e publikut në këto të dhëna, janë faqet zyrtare elektronike të Komunës.
- Gjatë kësaj periudhe raportuese, të gjitha aktet e miratuara dhe të konfirmuara nga organi mbikëqyrës MAPL janë publikuar në faqen elektronike të Komunës së Dragashit.

## IV. KOMITET OBLIGATIVE TË KK-së :

- Komiteti për Politikë dhe Financa

Gjatë kësaj periudhe Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsejtë 10 takime në harmoni me dispozitat ligjore, ku ka debatuar paraprakisht për materialet e Kuvendit, gjithashtu Komiteti për Politikë dhe Financa ka shqyrtuar edhe kërkesat që kanë të bëjnë me ndihma Financiare – për shërim dhe ndihma financiare të ndryshme.

Gjithashtu KPF ka diskutuar edhe për çështjet buxhetore, identifikimin dhe hartimin-miratimin e programeve zhvillimore dhe strategjike.

## - Komiteti për Komunitete

Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsejtë 10 takime, në harmoni me dispozitat ligjore, dhe atë sipas kompetencave ka diskutuar dhe promovuar të drejtat dhe interesat e komuniteteve të Komunës për t'u kontribuar në ruajtjen e marrëdhënieve stabile ndëretnike tek ne si dhe përcjelljen e qëndrimeve eventuale në Kuvendin e Komunës , gjithashtu ka debatuar edhe për materialet e Kuvendit, Gjithashtu Komiteti për Komunitete ka trajtuar edhe kërkesat e ndryshme që kanë të bëjnë me Komunitetin Jo shumicë.

## V. TUBIMET PUBLIKE DHE DËGJIME BUXHETORE

Gjatë vitit 2023 janë mbajtur 2 takime publike siç është e paraparë me ligj, takim i I-rë publik është mbajtur më dt. 14.06.2023 dhe takimi i II-të Publik është mbajtur më dt. 21.12.2023, gjithashtu janë mbajtur 9 dëgjime buxhetore si dhe 4 konsultime publike për Rregullore dhe Strategji.

## PËRFUNDIM

Ky raport përmbledhës paraqet ngjarjet kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Raporti i Kuvendit të Komunës së Dragashit është dëshmi e respektimit të dispozitave ligjore, në frymën e transparencës, llogaridhënies dhe performancës sa më të mirë të Komunës dhe i dedikohet të zgjedhurve nga qytetarët, monitoruesve dhe publikut të gjerë.

Mirëpresim kontributin e secilit që përmes vërejtjeve këshillave, plotësimeve që të i bëjmë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjmë sa më mirë punën tonë.

Ju faleminderit!

Me respekt,

Kryesuesja e Kuvendit

Arijeta Skeraj



*A. Skeraj*